



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 95, datë 26.07.2021

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESES, TË SHKOLLËS SË MESME “DHOSI LIPERI”, QË MBAN NR. 4, TË LISTËS, QË ME VKM NR. 297, DATË 28.4.2010, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË SUKTH (SOT BASHKIA DURRËS), PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE STRUKTURA E OBJEKTIT NË GJENDJEN EKZISTUESE NUK I PLOTËSON KUSHTET E SIGURISË DHE QËNDRUESHMËRISË PËR NJË VEND SIZMIK SIÇ ËSHTË DURRËSI, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË REALIZUAR NGA SHOQËRIA “ARKIMADE SHPK”, I KONFIRMUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PARAPRAKE TË PRONAVE, TË SHKOLLËS SË MESME “DHOSI LIPERI”, QË MBAN NR. 4 TË LISTËS SË TRANFERIMIT, ME VENDODHJE NË QENDËR SUKTH, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH, QË ME VKM NR. 297, DATË 28.4.2010, BËN PJESË NË LISTËN PARAPRAKE TË PRONAVE TË BASHKISË SUKTH (SOT BASHKIA DURRËS)

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 297, datë 28.04.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Sukth, të Qarkut Durrës”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr. 326/1 prot., datë 22.02.2021, ardhur nga Instituti i Ndërtimit, me lëndë “Konfirmim Akt ekspertize”, Ligjit nr. 10296/2010

“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesës, të Shkollës së Mesme “Dhosi Liperi”, që mban nr. 4, të listës, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe struktura e objektit në gjendjen ekzistuese nuk i plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë për një vend sizmik siç është Durrësi, kjo sipas aktekspertizës së realizuar nga Shoqëria “Arkimade shpk”, i konfirmuar nga Instituti i Ndërtimit.
2. Miratimin për heqjen nga lista paraprake e pronave të Njesisë Administrative Sukth, Bashkia Durrës, të pronës me nr. 4, me vendodhje në Qendër Sukth, Njësia Administrative Sukth, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, bën pjesë pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth, (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësia Administrative Sukth, që në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me nr.4, me vendodhje në Qendër Sukth, Njësia Administrative Sukth, që me VKM nr. 297, datë 28.04.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth, (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli) i liruar nga prishja e ndërtesës e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e ndërtesës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e ndërtesës e përcaktuar në pikën 1, të mbulohet nga institucioni përkatës, Inspektoriat i Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, që bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën

me Njësinë zbatuese (UNDP), që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e objektit me emërtimin shkolla e Mesme “Dhori Liperi”, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesës, pas realizimit të rindërtimit.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.07.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 349 prot.
8



Durrës, më 30.07.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.95 datë 26.07.2021 “Mbi miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesës, të shkollës së mesme “Dhosi Liperi”, që mban nr. 4, të listës, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe struktura e objektit në gjendjen ekzistuese nuk i plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë për një vend sismik siç është Durrësi, kjo sipas aktekspertizës së realizuar nga shoqëria “Arkimade shpk”, i konfirmuar nga Instituti i Ndërtimit dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake të pronave, të shkollës së mesme “Dhosi Liperi”, që mban nr. 4 të listës së transferimit, me vendodhje në qendër Sukth, njësia administrative Sukth, që me VKM Nr. 297, datë 28.4.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës)”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

